

“ISHA BULLIZUES”

i Andrea Franzosos

SKEDA 7

KAPITULLI 20-21-22-23-24



“Nuk jeni bere per te jetuar si kafshe”

Historia duket sikur po i afrohet një fundi të lumtur, por më pas situata përkeqësohet përsëri. Për çfarë krimi e gjen veten Danieli në burgun e Shën Vitores? Me kë e bëri atë?

Shën Vitore, ndryshe nga Bekaria, është një burg për të rritur. Çfarë të bëri më shumë përshtypje në përkrimin e autorit?

Çfarë është Rrezja e Gjashtë? Në ç' kuptim Danieli prek fundin duke u transferuar atje?

Fjalët janë të rëndësishme

1. Për të përshkruar gjendjen shpirtërore të Danielit në Shën Vitore, autori përdor fjalë dhe metafora që kanë të bëjnë me hapësirën. Për secilën prej tyre, shkruaj se çfarë të sjell ndër-mend:

Kishte mbërritur në stacionin e fundit: _____

asnjë dritare në horizont _____

rrëshqiste në një humnerë të thellë _____

labirint _____

mjegullën e dendur të vuajtjes _____

2. Pse, sipas teje, biblioteka përkufizohet si kuti magjike? A të pëlqen ky imazh? Apo të bën të mendosh për diçka tjetër? Çfarë?

3. “Të dish do të thotë ‘të kesh shije’, ‘të jesh i urtë’. Do të thotë të kesh shije për jetën”, thotë Fiorela. Mendoje jetën si një ushqim: çfarë shije ka për ty?

Përcaktimi i ndjenjave

1. ZHGËNJIMI: Danieli nuk vuan aq shumë nga zhgënjimi i tij, por nga zhgënjimi që u shkakton të tjerëve. “I kam zhgënjyer të gjithë”, thotë vazhdimisht ai. Për kë po flet? Kjo do të thotë se ai është i ndjeshëm. A je dakord?

2. MIRËNJOHJA: është ndjenja e atij që dëshiron t'i thotë “faleminderit” dikujt, një faleminderit të thellë. Për kë provon mirënjohje Danieli?

Shpesh nuk e shprehim mirënjohjen tonë. Ndoshta sepse të falënderuarit kërkon përpjekjen për të thënë atë që ndiejmë, për të shprehur një ndjenjë, për të ekspozuar pak veten. Përpiqu ta bësh këtë këtu. Faleminderit,

sepse _____

REFLEKTIM PERSONAL:

TË FLASËSH PËRMES METAFORAVE

Biblioteka bëhet një “kuti magjike”, një dritare, një “sy mbi botën”... vazhdoni ju: në çifte, shpikni një emër të imagjinuar për një objekt ose element që i përket shkollës. Shkruajeni në një copë letër dhe paloseni. Mblidhni të gjitha copat e letrës, nxirrini një nga një dhe përpiquni të merrni me mend se për çfarë bëjnë fjalë.

DEBAT: NË JETË NUK KA ASNJË SKENAR TË SHKRUAR MË PËRPARA

Skenari është teksti në të cilin janë shkruar të gjitha fjalët që duhet të thonë aktorët e një filmi ose të një shfaqjeje. “Kurrë mos harro se në jetë nuk ekziston një skenar i paracaktuar: **deri në fund mund të marrësh vendimin** për t'ia ndryshuar finalen”, i thotë Serrikoni Danielit. Secili prej nesh vendos se cilin drejtim të ndjekë dhe cilat rrugë të marrë, por a është ai vërtet i lirë të ndryshojë në çdo moment apo të bëjë zgjedhjet që ka bërë më parë, të cilat e kushtëzojnë atë? **Filloni një debat dhe përpiquni të citoni histori të vërteta për të mbështetur mendimet tuaja.**

NDJENJA:

BESIMI

"Dhuna është shenjë e varfërisë së të menduarit: është shprehja e dikujt që nuk di të komunikojë në një mënyrë tjetër". Komento fjalinë e Danielit, duke pasur parasysh se ekzistojnë shumë lloje dhune: fizike, verbale (përmes fjalëve), psikologjike etj.

A të kujtohet ndonjë episod në të cilin Danieli veproi dhunshëm, sepse nuk kishte mjete të tjera?

Në Shën Vitore, Danieli është viktimë e dhunës, pikërisht nga ata që duhet të mbikëqyrin dhe të garantojnë qetësinë. Çfarë ndodh?

Në fletoren tënde, trego një episod nga jeta jote që tregon se nëse i beson një personi, ai jep më të mirën e tij. Mendoni për shembull për sportin, shkollën, familjen...

Të rriturit: TË RRI TUR TË BESUESHËM

FIGURELA: vullnetare, ajo është një mësuese letërsie në pension e cila e bind Danielin të rifillojë studimet. Ai i thotë: "Daniel, do të vijë një moment në jetën tënde kur do të jesh në një telash aq të madh sa nuk do të mund të dalësh prej tij. Nuk do të shpëtojnë paratë, por dituria". Çfarë mendon ti? A je dakord? Argumentoje përgjigjen tënde.

DOM KLAUDIOJA nuk e braktis kurrë Danielin. Ditën e diplomimit ai i thotë: "Më në fund mund të ta them: jam krenar për ty, Daniel. Ti vlen: ngule mirë në kokë". Krejt e kundërta e asaj që dëgjon prej të atit në fillim të librit. Krejt historia e Danielit rrjedh midis këtyre dy momenteve. Përpiku ta përshkruash atë në 3 rreshta.

DOM KLAUDIOJA nuk e braktis kurrë Danielin. Ditën e diplomimit ai i thotë: "Më në fund mund të ta them: jam krenar për ty, Daniel. Ti vlen: ngule mirë në kokë". Krejt e kundërta e asaj që dëgjon prej të atit në fillim të librit. Krejt historia e Danielit rrjedh midis këtyre dy momenteve. Përpiku ta përshkruash atë në 3 rreshta.

TË STUDIO SH PËR TË SHPËTUAR VETEN

Danielit i duhej një motivim, një objektiv që do t'i jepte forcën për t'u përballur me jetën e vështirë të burgut. Dhe e gjeti në studim. Fiorela, vullnetarja që i përçoi dashurinë për letërsinë dhe kulturën, i reciton një varg nga Komedia Hyjnore e Dantes: "Nuk jeni bërë për të jetuar si kafshë, por për të ndjekur virtytin dhe diturinë", domethënë, "nuk u krijuat për të jetuar si qenie primitive, por për të ndjekur virtytin dhe dijen": është në natyrën e njeriut të dijë, të kërkojë shpjegime. Dhe në fakt, Danieli lexon duke kërkuar përgjigje për pyetjet e tij rreth jetës, pastaj përgatitet për provimet e shkollës së mesme dhe më në fund regjistrohet në universitet dhe diplomohet në Shkencat e Edukimit, i frymëzuar nga Dom Klaudioja, i cili ia ka kushtuar jetën pikërisht edukimit.

1. Sipas mendimit tënd, cili është qëllimi i studimit? Rendit të paktën 3 qëllime sipas rëndësisë.

2. E drejta për arsim është një nga të drejtat themelore të njeriut, si dhe një nga objektivat e Axhendës 2030 të OKB-së. Kushdo ka të drejtë të shkojë në shkollë dhe të mësojë. Edhe ata të mbyllur në burg, si Danieli. Në botë, shumë fëmijë (dhe veçanërisht vajzat) nuk e shohin këtë të drejtë të njohur. Pse nuk shkojnë në shkollë?

3. Pa arsimim nuk i di (dhe për këtë arsye nuk mund t'i mbrosh) të drejtat e tua. Pra, mbetesh në situatën e pafavorshme në të cilën ndodhesh. Dhe fëmijët e tu nuk do të shkojnë në shkollë, kështu që edhe ata nuk do t'i dinë të drejtat e tyre. Përpiku të mendosh për rrethin e kundërt të virtytshëm: nëse unë arsimohem...

4. Shkolla duhet të të edukojë rreth të bukurës, të të ndihmojë të zbulosh talentin dhe vendin tënd në botë. Sipas përvojës tënde, a është shkolla në gjendje që ta përmbushë këtë detyrë? Nëse po: si? Nëse jo: pse? Çfarë i mungon asaj? Shkruaj një tekst të shkurtër mbi këtë temë dhe përfundoje duke përshkruar shkollën tënde ideale.